



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3367/4 prot.

Tiranë, më 31.12.2021

VENDIM

Nr. 75, datë 28.12.2021

PËR

**“MIRATIMIN E KRITEREVE, DOKUMENTACIONIT DHE PROCEDURAVE TË PUNËSIMIT PËR POZICIONIN E PUNËS ‘ADMINISTRATOR’ I UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të nenit 3, 47, 49 (gërma f) e neneve në vijim të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, të nenit 5, 49, 51 (gërma q) e neneve në vijim të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të diskutimeve në mbledhjen e datës 28.12.2021 si dhe në Vendimin e Bordit të Administrimit të UMT nr. 74, datë 28.12.2021 “Për caktimin e Administratorit të përkohshëm, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret që duhen plotësuar dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar për pozicionin e punës Administrator i UMT-së, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur dhe pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Të miratojë hapat procedurale që do të ndiqen për këtë procedurë punësimi sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur dhe pjesë integrale e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Administratori i Përkohshëm i UMT-së, i cili në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore, të dërgojë për publikimin në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik, kriteret që duhen të plotësojnë dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë kandidatët për Administrator të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, sipas këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
ZAMIRA GJINI

ANËTARË

MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ

## Lidhja nr. 1

**Kandidatët për pozicionin e punës “Administrator i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë” duhet të plotësojnë kriteret dhe të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:**

### **1. Kriteret:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurron;
4. Të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin “Master i Shkencave”, në fushën e drejtësisë ose të ekonomisë dhe përvojë pune së paku 7 (shtatë) vjet në këto fusha., pas përfundimit të arsimit të lartë në fushat e kërkuara;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale;
6. Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore, që nuk është shuar sipas ligjit;
7. Të ketë vlerësime pozitive të përvojave të mëparshme të punës;
8. Të mos gjendet në kushtet e konfliktit të interesit;
9. Të zotërojë me dëshmi një nga gjuhët e huaja perëndimore (Anglisht, Frëngjisht, Spanjisht, Italisht, Gjermanisht);

### **2. Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidati/ët:**

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrimin (CV), si rregull sipas formatit standard (europass);
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe/ose njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listë notash të noteruara (të dy cikleve të studimit);
5. Kopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Vërtetim i gjendjes shëndetësore të marrë brenda 3 (tri) muajve të fundit (raport mjekësor për aftësinë në punë);
7. Formular vetëdeklarimi sipas formës së kërkuar nga ligji nr. 138/2015;
8. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) të marrë brenda tre muajve të fundit;
9. Vërtetim nga punëdhënës/i të mëparshëm/ fundit apo aktual, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
10. Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj të noterizuar;
11. Referenca nga punëdhënës të mëparshëm, që provojnë vlerësimet pozitive në punë;
12. Vetëdeklarim që nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit për pozicionin e punës “Administrator i UMT-së” që kandidon;
13. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Mungesa e një prej dokumentacioneve të kërkuara më sipër, sjell s'kualifikim të kandidatit. Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht kandidatit, pasi bëhet pjesë e arkivës së Institucionit.

### **3. Dorëzimi i dokumentacionit dhe afati i dorëzimit:**

1. Kandidatët e interesuar, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar, të inventarizuar, në zyrën e Protokoll-Arkivës, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në adresën: Rruga e Dibrës, nr. 371, 1005 - Tiranë, Shqipëri;
2. Afati i dorëzimit të dokumentacionit është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike që nga dita e shpalljes së njoftimit në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik, për këtë pozicion pune (Administrator i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë).
3. Ngarkohet Administratori i UMT-së, në bashkëpunim me sektorin e burimeve njerëzore të procedojë me shpalljen për konkurrim të hapur për pozicionin e Administratorit të UMT-së, në Agjencinë e Prokurimit Publik, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
4. Për çdo paqartësi mund të dërgohet e-mail në adresën: [info@umed.edu.al](mailto:info@umed.edu.al).



## Lidhja nr. 2

**Hapat procedurale që si rregull do të ndiqen për procedurën e punësimit të Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë**

Nr.		
1.	Miratimi i Kritereve nga Bordi i Administrimit për Administrator në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.	Në mbledhjen përkatëse të Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
2.	Publikimi i kritereve në Agjencinë e Prokurimit Publik .	Menjëherë pas zbardhjes së Vendimit të Bordit të Administrimit (Administratori në bashkëpunim me Strukturën e Burimeve Njerëzore në UMT).
3.	Afati i dorëzimit të dosjeve nga kandidatët për Administrator në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.	15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike që nga dita e shpalljes së kritereve dhe dokumenteve (njoftimit) në Buletinin e Njoftimeve të APP-së.
4.	Dorëzimi i dokumenteve nga kandidatët për pozicionin e punës “Administrator “ në UMT.	Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar, të <u>inventarizuar</u> , në zyrën e Protokoll-Arkivës, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në adresën: Rruga e Dibrës, nr. 371, 1005 - Tiranë, Shqipëri.
5.	Miratimi i listës me kandidatët që plotësojnë kriteret nga Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.	Pas përfundimit të afatit të aplikimeve për Administrator të UMT, dosjet i kalojnë Senatit Akademik të UMT-së, i cili do të miratojë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret.
6.	Vlerësimi i dosjeve të kandidatëve për Administrator në UMT nga Bordi i Administrimit dhe caktimi i datës së Intervistës.	Pas marrjes së Vendimit të Senatit Akademik të UMT, mbi listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret për Administrator të UMT.
7.	Zhvillimi i intervistës dhe shpallja e fituesit si Administrator i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.	Si rregull 3 (tri) ditë pune nga vlerësimi i dosjeve të kandidatëve për Administrator në UMT.
8.	Periudha e ankimimeve.	Nëse do të ketë ankimime Bordi i Administrimit të UMT-së, do t'i vlerësojë ato dhe do të shprehet me vendimin përkatës.